



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2020:026271

Datë: 12.05.2020

Numri i dokumentit: 00919316

P.nr.102/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen sekkretares juridike Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në lëndën penale kundër të pandehurit A.H. nga fsh. Sh. K. Lipjan, të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.647/20 të datës 19.02.2020, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e prokurorisë për dhënien e urdhërit ndëshkimor me datën 26.02.2020 merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Prishtinë, PP.II.nr.647/20 të datës 19.02.2020 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Kundër të pandehurit:

A.H., i biri i E., e ëma H., e gjinisë D., i lindur me dt. ... në P., jeton në fsh. Sh. K. Lipjan Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 22.01.2020 rreth orës 22:20min, në internet kafe "R." në fshatin Sh. K. Lipjan deri sa i dëmtuari L.H. ishte duke kumunikuar telefon me shokin e tij, pa pritmas i pandehuri i maskuar e godet mr shuplak në fytyrë të dëmtuarin.

-me këtë ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, në konform dispozitave të neneve, 1, 2, 3, 4, 6, 7, 17, 20, 21, 38, 39,40, 43, 69, si dhe nga neni 184 par.1 të KPRK-së dhe neneve 493, 495 dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin e gjykon me:

ME DËNIM ME GJOBË

Me dënim me gjobë në shumë prej **300.-€**, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguajë në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë konfrom nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

I dëmtuari: L.H. me vendbanim në fsh. Sh. K. Lipjan, udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizoi në kontest të rregullt civil.

OBLIGOHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20.-€ pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30.-€, në afat prej 15 dite nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP.II.nr.647/20 të datës 19.02.2020 e ka akuzuar të pandehurin A.H. fsh. Sh., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, dhe në të njëjtën datë ka kërkuar që të pandehurit ti shqiptohet urdhër ndëshkimor – dënim me gjobë për veprën e lartcekur penale.

Gjykata duke analizuar aktakuzën, si dhe kallximin penal me numër të rastit 2020AH 0101 i dt.05.02.2020, si dhe shkresave tjera të lëndës dhe foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes konstaton se ka prova të mjaftueshme në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitën e nenit 493 të KPPK-së parashihet se “Për vepra penale e cila parashihet dënimi me gjobë ose burgim deri në 3 (tre) vite, për të cilat prokurori i shtetit është i informuar me provat e besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do ti shqiptoi dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor”.

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit paraparak të çështjes konform nenit 493 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor ndaj të akuzuarit nga arsyet se dënimi për veprën penale me të cilën ngarkohet i akuzuari është dënim me gjobë apo me burgim deri në 3 (tri) vite, andaj gjykata konform dispozitave të lartcekura vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor u bazua konform nenit 450 par. 2 nën par. 2.1. dhe nën par. 2.6 të KPPK-së, , ndërsa vendimi për kompenzimin e viktimave të krimit u murr në bazë të nenit 39 par. 1 pika 1.3 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore- juridike, u bazua konform nenit 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN
P.nr.102/20 me dt.26.02.2020

Sekretarja juridike
Nexhmije Ahmeti

GJYQTARI
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë në kundërshtim në afat prej 8 (tetë) dite nga dita e marrjes së të njëjtit, kundërshtimi i drejtohet gjyqtarit individual të kësaj gjykate.

